



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

№ 382/1

dt 31.1.13

UDHËZIM
Nr 6, datë 31.1 2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR 25 DATË 30.11.2007 "PËR
PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË VLERËS DOGANORE, BURIMET E
INFORMACIONIT DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË DOSJES ME TË DHËNA TË
DISPONUESHME, SI DHE ZHDOGANIMIN E AUTOMJETEVE DHE PJESËVE TË
KËMBIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 36 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në pikën 81.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave" Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar", me propozimin e Komisionit *Ad-Hoc*, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Ne Sesionin II, pika 10 behen ndryshimet si me poshte:

10. Si burim informacioni për krijimin e dosjes me "Të dhënat e disponueshme" shërbejnë burimet e përcaktuara në pikat 10.1 deri në pikën 10.9.

Pas pikes 10.7 shtohen pikat 10.8 dhe 10.9, si me poshte:

10.8: Cmimet e publikuara nga kompania ICIS ne lidhje me artikujt petro-kimike te plastikes si polipropilene, polietilene, polistirene, polivinil.

10.9: Cmimet e publikuara nga kompania PROFERCY, ne lidhje me vlerat ne tregjet e plehrave kimike (plehra azotike, plehra fosfatike me nje, dy dhe tre elemente perberes)

2. Ky Udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode